

## THIRRJE E HAPUR PËR BASHKITË NËN PROJEKTIN DALIA

Projekti DALIA ka hapur thirrjen për aplikime në kuadrin e iniciativës "Rivers Revived", duke ftuar autoritetet lokale dhe/ose rajonale të marrin pjesë. Shqipëria është një nga shtetet e eligjable.

DALIA ka për qëllim të transferojë njohuritë e marra nga rajonet pilot të DALIA-s në rajone të reja pilot me kushte të ngjashme, duke angazhuar autoritetet lokale dhe rajonale për të zgjedhur një nga rajonet pilote dhe për ta përsëritur atë duke demonstruar kështu transferueshmërinë, fizibilitetin dhe shkallëzueshmërinë e zgjidhjeve të tilla që janë kryer në lumin Danub.

Aplikantët e mundshëm do të zgjedhin një ose disa aktivitetet e mëparshme që do të replikohen në rajonin përkatës të lidhur. Aktiviteti kryesor do të jetë riprodhimi i pilotit të përzgjedhur në rajonin përkatës. Kjo do të shoqërohet me një dokumentacion të plotë të zbatimit, vlerësimet nga palët e interesuara dhe impaktin e prishëm afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

### **Kush mund të aplikojë:**

Në këtë thirrje mund të aplikojnë vetëm autoritetet vendore dhe/ose rajonale.

Aplikantët mund të aplikojnë si një institucion i vetëm ose si një ekip prej deri në 3 institucione partnere nga një ose shumë vende të pranueshme. Në rast të paraqitjes së ekipit, një institucion do të veprojë si udhëheqës, por të gjithë institucionet e tjera do të duhet të jenë autoritete vendore ose rajonale.

### **Buxheti:**

Projekti do të financojë **10 propozime** nga të paktën **5 rajone të ndryshme**, me një mbështetje financiare deri në **100,000 EUR për secilën propozim**.

### **Llojet e aktiviteteve të pranueshme janë:**

- Revitalizimi i sistemeve ekologjike
- Monitorimi dhe restaurimi i ekosistemeve
- Rindërtimi i zonave të përmytura
- Rindërlidhja e lumenjve
- Rehidrimi i pellgjeve lumore
- Menaxhimi i sedimentit
- Pastrimi i mbeturinave në lumenj dhe ekosistemet përreth

**Afati i fundit për aplikim:** 16 tetor 2024, ora 17:00 CEST.

### **Linku i thirrjes:**

<https://kms.dalia-danube.eu/open-call/>